PROGRAMI I TRAJNIMIT

“BAZAT E DIDAKTIKËS NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL”

(PËR MËSIMDHËNËSIT E KULTURËS PROFEESIONALE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË SHQIPËRI)

(Kodi: PK-Y-1-25)

Tiranë, Dhjetor 2025

PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT TË VAZHDUAR PËR MËSIMDHËNËSIT E KULTURËS PROFESIONALE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË SHQIPËRI

"BAZAT E DIDAKTIKËS NË AFP"

(PK-Y-1-25)

I. Qëllimi i programit të kursit të trajnimit

Programi i Kursit të Trajnimit të Vazhduar për Mësimdhënësit e kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri, i fokusuar te "Bazat e didaktikës në AFP", ka për qëllim të fuqizojë njohuritë dhe zhvillojë aftësitë e mësimdhënësve për të planifikuar dhe realizuar me efektivitet procese mësimore teorike-praktike që zhvillojnë te nxënësit dhe kursantët kompetencat profesionale të nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

II. Kompetencat që fitojnë pjesmarrësit në përfundim të kursit të trajnimit

Në përfundim të kursit të trajnimit "Bazat e didaktikës në AFP", pjesmarrësit do të jenë të aftë të:

- Interpretojnë dhe zbatojnë kuadrin ligjor dhe dokumentacionin që përdoret në sistemin e AFP.
- Interpretojnë dhe zbatojnë kuadrin ligjor që lidhet me profesionin e mësimdhënësit në AFP.
- Përgatisin dhe mirëmbajnë mjedisin dhe mjetet mësimore për realizimin e mësimit.
- Përgatisin dhe plotësojnë dokumentacionin për realizimin e mësimit.
- Zbatojnë parimet e didaktikës moderne në procesin mësimor.
- Përshtasin mësimin në përputhje me veçoritë psikologjike të nxënësve dhe kursantëve.
- Zbatojnë qasje dhe proçese mësimore teorike dhe praktike në mbështetje të të nxënit aktiv të nxënësve dhe kursantëve.
- Krijojnë atmosferë pozitive, komunikuese dhe motivuese në proçesin mësimor.
- Zbatojnë parimet e gjithpërfshirjes, barazisë dhe diversitetit në procesin mësimor.
- Përgatisin materiale mësimore mbështetëse për procesin mësimor.
- Përdorin medie të ndryshme didaktike në mbështetje të procesit mësimor.
- Përdorin mjedisin, mjetet dhe materialet digjitale në procesin mësimor.
- Realizojnë mësime online dhe të kombinuara (*blended*).
- Përgatitin instrumente për vlerësimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve të nxënësve dhe kursantëve.
- Përgatisin materiale mësimore digjitale dhe instrumente vlerësimi digjitale.
- Kryejnë vlerësime të vleftshme, të paanshme dhe të besueshme të nxënësve dhe kursantëve.
- Plotësojnë dokumentacionin shkollor digjital.

- Shkëmbejnë informacione dhe përvoja, online, nëpërmjet komuniteteve të praktikës.
- Planifikojnë procese mësimore teorike dhe/ose praktike.
- Realizojnë procese mësimore që zhvillojnë njohuritë teorike, shprehitë praktike dhe "aftësitë e buta" të nxënësve dhe kursantëve.
- Krijojnë mjedise dhe procese mësimore "miqësore", të sigurta dhe në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

III. Kohëzgjatja e kursit të trajnimit

Kursi i trajnimit ka një kohëzgjatje prej 270 orësh, ku 180 orë (30 ditë) janë trajnim i drejtpërdrejtë (me prezencë fizike dhe/ose i kombinuar) dhe 90 orë janë trajnim jo i drejtpërdrejtë.

IV. Kërkesat e pranimit në kursin e trajnimit.

Pjesëmarrësit në kursin e trajnimit "Bazat e didaktikës në AFP" duhet të jenë të punësuar me kohë të plotë në institucionet ofruese të AFP (shkolla profesionale ose qendra të formimit profesional), si:

a) mësimdhënës (fillestarë ose në vijim) të teorisë dhe/ose praktikës profesionale, të cilët kanë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershëm, në fushat profesionale përkatëse.

b) mësimdhënës (fillestarë ose në vijim) të praktikës profesionale, të cilët kanë shkollim të mesëm profesional ose pas të mesëm profesional ose diplomë të nivelit Bachelor, në fushat profesionale përkatëse..

V. Modulet e kursit të trajnimit.

Nr	Titulli i modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit (RN)
1	**Hyrje në profesionin e mësimdhënësit në AFP**	MK-27-194-25	12 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 50% në format online	1. Pjesëmarrësi analizon strukturën dhe veçoritë e sistemit të AFP. 2. Pjesëmarrësi përshkruan ciklin e AFP të bazuar te kompetencat. 3. Pjesëmarrësi analizon veçoritë e Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri. 4. Pjesëmarrësi analizon veçoritë e profesionit të mësimdhënësit në AFP.
2	**Hyrje në psikologjinë e të nxënit**	MK-27-019-25	12 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 70% në format online	1. Pjesëmarrësi analizon aspektet psikologjike të të nxënit. 2. Pjesëmarrësi analizon stilet dhe veçoritë e të nxënit të adoleshentit dhe të rriturit. 3. Pjesëmarrësi analizon faktorët social-kulturorë që ndikojnë në të nxënit.

3	**Veçoritë e didaktikës moderne në AFP**	MK-27-195-25	24 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 12 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 40% në format online	1. Pjesëmarrësi analizon parimet e didaktikës moderne në AFP. 2. Pjesëmarrësi përcakton objektivat dhe përmbajtjet mësimore. 3. Pjesëmarrësi përdor metoda mësimore aktive, që zhvillojnë kompetencat e punësimit. 4. Pjesëmarrësi analizon rolin e mësimdhënësit si lehtësues i të nxënit aktiv.
4	**Krijimi i atmosferës pozitive në procesin mësimor**	MK-27-196-25	12 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 50% Teori 40% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 70% në format online	1. Pjesëmarrësi nxit etikën, komunikimin efektiv dhe veprimtaritë socio-emocionale në mjedisin mësimor. 2. Pjesëmarrësi zhvillon aftësitë kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës, të nxënësve dhe kursantëve. 3. Pjesëmarrësi zbaton parimet e barazisë, gjithpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor. 4. Pjesëmarrësi harton dhe zbaton planin individual për nxënësit dhe kursantët në rrezik braktisje.
5	**Menaxhimi i mjedisit, mjeteve dhe materialeve mësimore në AFP**	MK-27-021-25	18 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 9 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 30% në format online	1. Pjesëmarrësi përgatit dhe mirëmban mjedisin dhe mjetet mësimore. 2. Pjesëmarrësi përdor medie mësimore. 3. Pjesëmarrësi përgatit materiale mësimore mbështetëse.
6	**Vlerësimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP**	MK-27-022-25	30 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 15 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 50% në format online	1. Pjesëmarrësi analizon kuptimin, rëndësinë, parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. 2. Pjesëmarrësi përshkruan format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. 3. Pjesëmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve. 4. Pjesëmarrësi përgatit rubrika për vlerësimin dhe provimet e nxënësve dhe kursantëve.
7	**Mjedisi dhe mësimi digjital në AFP**	MK-27-197-25	30 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 15 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime Rreth 70% në	1. Pjesëmarrësi përdor mjedisin dhe mjetet digjitale për mësimin digjital. 2. Pjesëmarrësi përgatit materiale didaktike digjitale. 3. Pjesëmarrësi përgatit instrumente dhe kryen vlerësimin digjital të nxënësve dhe kursantëve.

			format online	4. Pjesëmarrësi realizon mësimin online dhe të kombinuar (*blended*). 5. Pjesëmarrësi angazhohet në rrjetet profesionale online. 6. Pjesëmarrësi menaxhon dokumentacionin dhe informacionin digjital shkollor.
8	**Planifikimi dhe realizimi i mësimit në AFP**	MK-27-023-25	42 orë trajnim i drejtpërdrejtë + 21 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 10% Teori 70% Praktikë 20% Vlerësime Rreth 30% në format online	1. Pjesëmarrësi përgatit plane të mësimdhënies për lëndët dhe modulet mësimore. 2. Pjesëmarrësi përshkruan veçoritë dhe fazat e mësimit teorik dhe mësimit praktik në AFP. 3. Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron mësime teorike. 4. Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron mësime praktike.

VI. Udhëzime për realizimin e kursit të trajnimit.

Lektorët dhe moderatorët e kursit të trajnimit "Bazat e didaktikës në AFP" duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të pjesëmarrësve dhe të çojnë në krijimin te ta, të kompetencave të plota dhe të qëndrueshme si mësimdhënës në AFP.

Procesi i trajnimit duhet të bazohet në një analizë fillestare, e cila të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes dhe formimi paraprak i pjesëmarrësve, rezultatet mësimore dhe përmbajtja e hollësishme e moduleve teorike – praktike të parashikuara, mundësitë reale për realizimin e veprimtarive trajnuese etj.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në këtë trajnim është *motivimi i pjesëmarrësve*. Njohja e vazhdueshme e pjesëmarrësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga lektorët dhe moderatorët e kursit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit të mësimdhënësit në AFP. Parimi i "të nxënit duke bërë" duhet të gjejë hapësirë të konsiderueshme në procesin e trajnimit.

Lektorët dhe moderatorët duhet të përdorin forma dhe metoda të tilla trajnimi që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehitë praktike të pjesëmarrësve, por edhe qëndrimet e tyre si mësimdhënës. Integrimi i teorisë me praktikën, shpjegimet e ilustruara, puna në grup, dhënia e detyrave, loja me role, demonstrimet praktike, diskutimet në grupe etj., këto duhet të jenë format dhe metodat bazë të këtij trajnimi.

Secili pjesëmarrës në kurs duhet të krijojë "portofolin" e trajnimit i cili përmban dokumentimin e veprimtarive dhe arritjeve të pjesëmarrësit dhe që shërben, si për vlerësimin e tij përfundimtar, ashtu edhe për lehtësimin e zbatimit të aftësive të fituara në praktikën e ardhshme mësimore.

Një parim tjetër që duhet zbatuar nga lektorët dhe moderatorët e kursit të trajnimit është fakti që të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e trajnimit, por edhe jashtë tyre. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e pjesëmarrësve ka një ndikim të dukshëm në zhvillimin e kompetencave mësimdhënëse të pjesëmarrësve në trajnim.

Një pjesë e madhe e trajnimit (rreth 40% ÷ 50%) do të realizohet *nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë* (fizik) të trajnerëve dhe të pjesëmarrësve, për të mundësuar shkëmbimin e përvojës dhe metoda të tjera të trajnimit aktiv. Pjesa tjetër e trajnimit, do të realizohet në *formatin e trajnimit online dhe të kombinuar* (blended), në mjedise trajnimi dixhitale,

mbështetur nga mjete, materiale trajnimi dhe instrumente vlerësimi dixhitale. Eshtë ekipi i trajnerëve dhe drejtuesve të programit të trajnimit që do të analizojë rrethanat dhe mundësitë konkrete, grupin e synuar dhe faktorë të tjerë, dhe *do të përcaktojë formatet dhe metodologjitë përfundimtare* për realizimin e këtij kursi trajnimi.

VII. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.

Vlerësimi i vazhduar i pjesëmarrësve në modulet teorike-praktike bëhet nga lektorët dhe moderatorët e seancave të trajnimit, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura dhe të përzgjedhura nga vetë ata.
Vlerësimi i pjesëmarrësve bëhet me nota (4 – 10) si për modulet teorike-praktike, ashtu edhe në provimin përfundimtar. Nota minimale për kalim është nota 5.
Vlerësimi i vazhduar i pjesëmarrësve bëhet me notë për çdo modul mësimor, notë e cila llogaritet si mesatare e notave të fituara në secilin rezultat mësimor të modulit përkatës.
Për vlerësimin e vazhduar të pjesëmarrësve në lidhje me aspektet teorike rekomandohen instrumente vlerësimi të tilla si pyetje përgjigje me gojë, teste me shkrim, bashkëbisedime dhe kontrolli i portofolit të pjesëmarrësit, ndërsa në lidhje me aspektet praktike rekomandohen listat e kontrollit gjatë demonstrimeve praktike. Rekomandohet që, sipas rastit, të përdoren dhe *instrumente vlerësimi në format digjital*.

Në fazën përmbyllëse të Kursit të Trajnimit "Bazat e didaktikës në AFP", pjesëmarrësit i nënshtrohen ***Provimit Përfundimtar teoriko-praktik***.

Gjatë provimit përfundimtar teoriko-praktik, çdo pjesëmarrës demonstron (simulon) praktikisht fazat e një seance mësimore teorike dhe/ose praktike. Ata i nënshtrohen edhe një testi të shkurtër teorik, me shkrim. Në këtë provim përfundimtar pjesëmarrësi vlerësohet për:
a) Aspektet praktike të realizimit të demonstrimit të mësimit (organizimin e mjedisit dhe mjeteve mësimore, realizimin e seancës mësimore, plotësimin e dokumentacionit zyrtar).
b) Aspektet teorike të procesit mësimor (plotësimi i portofolit të mësimdhënësit: ditari i seancës mësimore, objektivat e mësimit, metodat mësimore, materialet mësimore, udhëzuesit, ilustrimet, testet etj.).

Të dyja këto aspekte teorike dhe praktike, me kërkesë të pjesëmarrësit dhe me miratimin e trajnerëve, mund të realizohen nga pjesëmarrësi dhe të vlerësohen nga trajnerët edhe në *formatin online dhe të kombinuar* (*blended*).

Me përfundimin e suksesshëm të kursit të trajnimit, pjesëmarrësit pajisen me ***Certifikatën*** përkatëse e cila përmban:

a) Të dhënat për pjesëmarrësin, ofruesin e kursit të trajnimit, vitin kur kryhet kursi etj.
b) Të dhënat për kursin e trajnimit (emërtimin, kohëzgjatjen, listën e moduleve etj.).
c) Të dhëna për vlerësimin përfundimtar (me notë) të pjesëmarrësit të arritur në përfundim të kursit të trajnimit.

VIII. Përshkruesit e moduleve të kursit të trajnimit "Bazat e didaktikës në AFP" për mësimdhënësit e kulturës profesionale të AFP në Shqipëri.

1. Moduli "Hyrje në profesionin e mësimdhënësit në AFP".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**HYRJE NË PROFESIONIN E MËSIMDHËNËSIT NË AFP**	**MK-27-194-25**
Qëllimi i modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit njihen me konceptet, strukturën, tiparet dhe veçoritë e sistemit të AFP në Shqipëri, si dhe me veçoritë e profesionit të mësimdhënësit në AFP.	
Kohëzgjatja e Modulit	12 orë (2 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 50% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi analizon strukturën dhe veçoritë e sistemit të AFP. **RN2:** Pjesëmarrësi përshkruan ciklin e AFP të bazuar te kompetencat. **RN3:** Pjesëmarrësi analizon veçoritë e Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri. **RN4:** Pjesëmarrësi analizon veçoritë e profesionit të mësimdhënësit të AFP.	
RN1	**Pjesëmarrësi analizon strukturën dhe veçoritë e sistemit të AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi dhe roli i AFP në shoqëri. • Kuptimi për kualifikimet profesionale. • Veçoritë e AFP, dallimet midis arsimit të përgjithshëm, arsimit profesional (AP) dhe formimit profesional (FP). • Format dhe modelet e AFP. • AFP me bazë shkollën dhe AFP me bazë ndërmarrjen (AFP i dyfishtë). • Veçoritë e AFP të dyfishtë në Shqipëri. • Veçoritë e AFP bazuar te kompetencat e punës. • Struktura e sistemit të arsimit dhe e sistemit të AFP në Shqipëri. • Ligjet bazë dhe aktet nënligjore kryesore në të cilat mbështetet sistemi i AFP në Shqipëri. • Institucionet qendrore dhe mbështetëse të AFP në Shqipëri. • Ofruesit e AFP publik (shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional) dhe jopublik. • Partneriteti social në AFP. • Lidhja e AFP me botën e punës.	

	Udhëzime për realizimin: o Shpjegim i ilustruar me shembuj dhe prezantime në *powerpoint*. o Diskutime për aspekte të ndryshme të sistemit të AFP. o Punë në grupe për aspekte të ndryshme të AFP. o Detyra individuale për mbledhje informacioni në lidhje me sistemin e AFP në Shqipëri dhe profesionin e mësimdhënësit në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi përshkruan ciklin e AFP të bazuar te kompetencat.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Elementet e ciklit të AFP modern, bazuar te kompetencat e punës. • Profesionet dhe klasifikimi i tyre. • Standardet e profesioneve. • Kualifikimet profesionale dhe klasifikimi i tyre. • Përshkrimet e kualifikimeve profesionale. • Kurrikulat e AFP, skeletkurrikulat e AP dhe programet e kurseve të FP • Procesi mësimor në AP. • Procesi i trajnimit në FP. • Procesi mësimor në AFP të dyfishtë. • Vlerësimi, provimet dhe certifikimi në AFP. • Kualifikimi i vazhdueshëm dhe punësimi. • Orientimi i karrierës në AFP. • Tregu i punës dhe tregu i kualifikimeve. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim i ilustruar me shembuj dhe prezantime në *powerpoint*. o Diskutime për elementet e të AFP të bazuar te kompetencat. o Punë në grupe për analizën e elementeve bazë të ciklit të AFP. o Detyra individuale për mbledhje informacioni në lidhje me konceptet që përmban cikli modern i AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN3	**Pjesëmarrësi analizon veçoritë e Kualifikimeve Profesionale në Shqipëri.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Korniza Europiane e Kualifikimeve (KEK) dhe Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK).

	• Nivelet e KSHK dhe përshkruesit e niveleve. • Kualifikimet profesionale në Shqipëri, nivelet përkatëse. • Kualifikimet formale, joformale dhe informale, njohja e kualifikimeve të mëparëshme. • Kompetenca dhe kompetenca profesionale. • Përbërja, llojet dhe veçoritë e kompetencave profesionale. • Njohuritë, llojet dhe veçoritë e njohurive. • Shprehitë, llojet dhe veçoritë e shprehive. • Qëndrimet, llojet dhe veçoritë e qëndrimeve. • Kuptimi për kurrikulën. • Veçoritë e kurrikulës së AFP. • Llojet dhe modelet strukturore të kurrikulës. • Nivelet e hartimit, miratimit dhe të zbatimit të kurrikulës. • Modelet e kurrikulave të AP dhe të FP në Shqipëri. • Kurrikulat modulare bazuar te kompetencat e punës. • Skeletkurrikulat dhe kurrikulat shkollore në AP. • Programet e kurseve të unifikuara dhe kurseve të veçanta në FP. • Veçoritë e kurrikulave në AFP të dyfishtë. • Elementet e kurrikulave të AFP. • Shembuj kurrikulash të AFP, të bazuara te kompetencat e punës. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj dhe prezantime në *powerpoint*. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për veçoritë e kualifikimeve profesionale. o Punë në grupe për analizën e elementeve të kualifikimeve profesionale. o Detyra për mbledhje informacioni në lidhje me kualifikimet dhe modelet kurrikulare. o Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN4	**Pjesëmarrësi analizon veçoritë e profesionit të mësimdhënësit në AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Statusi i mësimdhënësit në AFP. • Nën-kategoritë dhe veçoritë e mësimdhënësve në AFP. • Mentorët e biznesit në AFP të dyfishtë. • Mundësitë e punësimit të mësimdhënësve në AFP. • Detyrat dhe funksionet e mësimdhënësit në AFP. • Mjedisi i punës së mësimdhënësit në AFP. • Kërkesat për mësimdhënësit në AFP. • Shkallët e karrierës dhe nivelet e kualifikimit të mësimdhënësve të AFP.

	• Kualifikimi fillestar (*pre-service*) i mësimdhënësve në AFP. • Zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve në AFP. • Kuadri ligjor për ushtrimin e profesionit të mësimdhënësit në AFP. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj dhe prezantime në *powerpoint*. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesmarrësve për statusin dhe veçoritë e mësimdhënësve të AFP. o Punë në grupe për analizën e tipareve të mësimdhënësve në AFP. o Detyra për mbledhje informacioni në lidhje me tiparet e mësimdhënësve në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

2. Moduli "Hyrje në psikologjinë e të nxënit"

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**HYRJE NË PSIKOLOGJINË E TË NXËNIT**	**MK-27-019-25**
Qëllimi i Modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit njihen me veçoritë psikologjike dhe stilet e të nxënit të nxënësve dhe kursantëve, të rinj dhe të rritur, si dhe me faktorët që ndikojnë në aspektet psikologjike të të nxënit.	
Kohëzgjatja e Modulit	12 orë (2 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 70% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1**: Pjesëmarrësi analizon aspektet psikologjike të të nxënit. **RN2**: Pjesëmarrësi analizon stilet dhe veçoritë e të nxënit të adoleshentit dhe të rriturit. **RN3**: Pjesëmarrësi analizon faktorët social-kulturorë që ndikojnë në të nxënit**.**	
RN1	**Pjesëmarrësi analizon aspektet psikologjike të të nxënit.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Proceset fiziologjike të të nxënit. • Memoria dhe struktura e njohurisë. • Llojet e memories dhe faktorët që ndikojnë në memorizim: - memoria afatshkurtër; - memoria e punës; - memoria afatgjatë; - memoria semantike (me bazë interesin); • Proceset rregullatore që ndikojnë te të nxënit • Rëndësia e njohurisë paraprake në të nxënit e njohurive të reja • Emocionet dhe të nxënit • Motivimi • Stresi dhe të nxënit • Menaxhimi i stresit në procesin mësimor • Zgjidhja e problemeve dhe arsyetimi. • Të nxënit aktiv • Aspektet psikologjike që ndikojnë në braktisjen shkollore. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj nga përditshmëria në AFP dhe me video ilustruese. o Ndarje në grupe të vogla për studime rasti të përbashkëta në lidhje me	

	çështjet e trajtuara në RN1, me fokus në menaxhimin e emocioneve dhe stresit, motivimin dhe nxitjen e memories semantike. o Vlerësimi i vazhduar me anë të studimit të rastit. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të trajnimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi analizon stilet dhe veçoritë e të nxënit të adoleshentit dhe të rriturit.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Si mësojnë adoleshentët. • Si mësojnë të rriturit. • Dallimet midis nxënësit rishtar dhe kursantit të rritur. • Stilet bazë të të nxënit. • Karakteristikat e stileve të të nxënit: – karakteristikat njohëse (kognitive); – karakteristikat afektive; – karakteristikat biheviorale. • Të nxënit te nxënës/kursantë me nevoja të veçanta. • Inteligjencat e shumëfishta. • Karakteristikat e nxënësit/kursantit (njohuritë ekzistuese, aftësitë, motivimi, qëndrimi dhe stili i të nxënit) në AFP. • Programe dhe metodologji për nxënësit/kursantët me nevoja të veçanta dhe me probleme të analfabetizmit funksional. • Të nxënit, vetëvlerësimi dhe qasja pozitive ndaj jetës. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj. o Studime rasti për grupe të vogla të pjesëmarrësve, referuar stileve të ndryshme të të nxënit, për nevojat e veçanta dhe analfabetizmin funksional. o Vlerësimi i vazhduar gjatë diskutimeve dhe me anë të studimit të rastit. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN3	**Pjesëmarrësi analizon faktorët social-kulturorë që ndikojnë në të nxënit.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Të nxënit në kontekstin kulturor: - të nxënit e individit dhe familja; - të nxënit e individit dhe shoqëria; • Të nxënët në kontekstin social: - të nxënit e individit dhe sistemi i edukimit/formimit;

	- etika dhe pritshmëria ndaj nxënësit/kursantit në kontekstin social, profesional; - edukimi gjinor dhe zhvillimi i karrierës ne këtë kontekst; • Të nxënit si proces holistik dhe ndërveprues mes individit dhe shoqërisë: - strategjitë e mësimdhënies për akomodimin e faktorëve socialë dhe kulturorë, nevojave të veçanta të nxënësve/kursantëve; - veprimtari në nivel ofruesi për të minimizuar barrierat sociale e kulturore dhe nevojat e veçanta të nxënësve/kursantëve. - korrektimi i njohurive paraprake dhe aftësive specifike përmes programeve urë për të siguruar pjesëmarrje dhe proces të qëndrueshëm të të nxënit; - programe/metodologji për individualizimin e procesit mësimor. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj. o Bashkëbisedim. o Ndarje në grupe të vogla për studime rasti dhe zgjidhje të përbashkëta, referuar aspekteve socio-kulturore të të nxënit. o Vlerësimi i vazhduar gjatë diskutimeve dhe me anë të studimit të rastit o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

3. Moduli "Veçoritë e didaktikës moderne në AFP".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**VEÇORITË E DIDAKTIKËS MODERNE NË AFP**	**MK-27-195-25**
Qëllimi i modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit njihen me parimet dhe elementet themelore të didaktikës moderne në AFP, me rolet e mësimdhënësit, si dhe aftësohen për të hartuar objektiva mësimore, për të përcaktuar përmbajtje mësimore dhe për të zbatuar metoda efektive mësimore në AFP.	
Kohëzgjatja e Modulit	24 orë (4 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 12 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 40% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi analizon parimet e didaktikës moderne në AFP. **RN2:** Pjesëmarrësi përcakton objektivat dhe përmbajtjet mësimore. **RN3:** Pjesëmarrësi përdor metoda mësimore aktive, që zhvillojnë kompetencat e punësimit. **RN4:** Pjesëmarrësi analizon rolin e mësimdhënësit si lehtësues i të nxënit aktiv.	
RN1	**Pjesëmarrësi analizon parimet e didaktikës moderne në AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** o Kuptimi për parimet didaktike. o Rëndësia e zbatimit të parimeve didaktike në procesin mësimor në AFP. o Karakteri shkencor i të nxënit. o Karakteri edukues dhe zhvillues i të nxënit. o Lidhja e teorisë me praktikën në procesin e të nxënit në AFP. o Konkretizimi dhe vizualizimi i njohurive në AFP. o Karakteri sistematik dhe gradual i të nxënit. o Nxitja e të nxënit të vetëdijshëm dhe aktiv. o Të nxënit e qëndrueshëm dhe afatgjatë. o Përshtatja e të nxënit me nivelin e zhvillimit dhe veçoritë moshore të nxënësve/kursantëve. o Veçoritë e zbatimit të parimeve didaktike në AFP. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve nga praktika e mësimdhënies për zbatimin e parimeve didaktike në AFP. o Punë në grupe për analizën e parimeve didaktike në AFP. o Detyra për mbledhje informacioni në lidhje me parimet didaktike në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna.	

	○ Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi përcakton objektivat dhe përmbajtjet mësimore.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore*:** • Kuptimi dhe hierarkia e ***objektivave mësimore.*** • Veçoritë e objektivave mësimore në AFP. • Kriteret e hartimit të objektivave specifike mësimore bazuar në synimet e lëndës/temës dhe në RN-të e modulit. • Struktura e një objektivi mësimor specifik. • Kriteret për përzgjedhjen dhe renditjen e objektivave mësimore. • Formulimi i objektivave mësimore që i referohen njohurive. • Formulimi i objektivave mësimore që i referohen shkathtësive. • Formulimi i objektivave mësimore që i referohen qëndrimeve (aftësive të buta). • Kuptimi për ***përmbajtjet mësimore***. • Marrëdhëniet midis përmbajtjeve të punës, përmbajtjeve të kualifikimeve dhe përmbajtjeve mësimore. • Temat/çështjet mësimore teorike. • Veprimtaritë mësimore praktike në AFP. • Kriteret e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore. • Hartimi i temave/çështjeve mësimore që i referohen njohurive teorike. • Hartimi i veprimtarive mësimore që i referohen shprehive praktike. • Hartimi i veprimtarive mësimore që i referohen qëndrimeve (aftësive të buta). • Hartimi i veprimtarive mësimore për aspektet ndër-disiplinore (siguria, mbrojtja e mjedisit, digjitalizimi, sipërmarrja etj.). ***Udhëzime për realizimin:*** ○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. ○ Shembuj të tipeve të ndryshme të objektivave mësimore specifike ○ Shembuj të formateve të ndryshme të përmbajtjeve mësimore teorike (temave/çështjeve) dhe praktike (veprimtarive). ○ Punë në grupe për formulimin e objektivave mësimore specifike dhe përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore. ○ Detyra individuale për formulimin e objektivave mësimore dhe përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore. ○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me formulimin e objektivave dhe përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore. ○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. ○ Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

RN3	**Pjesëmarrësi përdor metoda mësimore aktive, që zhvillojnë kompetencat e punësimit.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për "metodën mësimore". • Roli i metodave mësimore në zhvillimin e procesit mësimor në AFP moderne. • Veçoritë e metodave mësimore në AFP moderne. • Veçoritë e metodave mësimore që zhvillojnë njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet e lidhura me kompetencat e punësimit të nxënësve dhe kursantëve. • Metodat mësimore që zhvillojnë <u>të nxënit e orientuar nga veprimi</u>: - kuptimi i të nxënit të orientuar nga veprimi; - karakteristikat dhe përfitimet e të nxënit të orientuar nga veprimi; - roli i të nxënit të orientuar nga veprimi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve/kursantëve për zgjidhje problemesh dhe punësim; - kërkesat, burimet dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e të nxënit të orientuar nga veprimi në kontekstin e AFP; • Metodat mësimore që zhvillojnë <u>të nxënit nëpërmjet përvojës</u>: - kuptimi i të nxënit nëpërmjet përvojës; - katër fazat e "modelit të të nxënit nëpërmjet përvojës" (përvoja reale; vëzhgimi reflektiv; krijimi i konceptit; zbatimi i konceptit); - ndikimi i "reflektimit ndaj përvojës" për krijimin e koncepteve dhe shprehive të qëndrueshme te nxënësit/kursantët; - veprimtaria e nxënësve/kursantëve në të nxënit nëpërmjet përvojës (pyetjet, eksplorimi, eksperimetimi, kryerja e detyrave praktike, zgjidhja e problemeve, marrja e përgjegjësive, kurioziteti, iniciativa, vendimmarrja). - roli i të nxënit nëpërmjet përvojës për të zhvilluar aftësitë e nxënësv dhe kursantëve për zgjidhje problemesh dhe punësim; - kërkesat, burimet dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e të nxënit nëpërmjet përvojës në kontekstin e AFP; • Metodat mësimore që zhvillojnë <u>të nxënit aktiv dhe bashkëpunues</u>: - kuptimi i të nxënit aktiv dhe bashkëpunues (puna në grup); - karakteristikat dhe përfitimet e të nxënit aktiv dhe bashkëpunues; - roli i të nxënit aktiv dhe bashkëpunues për të zhvilluar aftësitë e nxënësve/kursantëve për zgjidhje problemesh dhe punësim; - kërkesat, burimet dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e të nxënit aktiv dhe bashkëpunues në kontekstin e AFP; • Metodat mësimore që zhvillojnë <u>të nxënit e bazuar në projektet</u>: - kuptimi i të nxënit të bazuar në projektet; - fazat e të nxënit të bazuar në projektin; - karakteristikat dhe përfitimet e të nxënit të bazuar në projektet; - roli i të nxënit të bazuar në projektet për të zhvilluar aftësitë e nxënësve dhe kursantëve për zgjidhje problemesh dhe punësim;

	- kërkesat, burimet dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e të nxënit bazuar në projektet në kontekstin e AFP; • "Formate" të ndryshme të organizimit të procesit mësimor në AFP (në klasë, në laborator, në repart pune, në mjedise reale pune, në mjedise pune të simuluara, në mjedise virtuale, "*online*", "*blended learning*", "*flipped classroom*" etj.). • Lista dhe veçoritë e metodave tipike që zbatohen në procesin mësimor teorik në AFP. • Lista dhe veçoritë e metodave tipike që zbatohen në procesin mësimor praktik në AFP. • Kriteret e përzgjedhjes së metodave mësimore në AFP. • Përzgjedhja e metodave mësimore për mësimin e orientuar nga teoria. • Përzgjedhja e metodave mësimore për mësimin e orientuar nga praktika. • Përzgjedhja e metodave që zhvillojnë qëndrimet e nxënësve/kursantëve. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të metodave mësimore për mësime teorike dhe mësime praktike. o Video ilustruese. o Punë në grupe për përzgjedhjen e metodave mësimore. o Detyra individuale për përzgjedhjen e metodave mësimore specifike. o Prezantime të punëve në grupe dhe detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me metodat mësimore të përzgjedhura. o Simulime të zbatimit të metodave të ndryshme mësimore. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN4	**Pjesëmarrësi analizon rolin e mësimdhënësit si lehtësues i të nxënit aktiv.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore***: • Përparësitë dhe mangësitë e rolit të mësimdhënësit "tradicional" në AFP. • Kërkesat e të nxënit aktiv dhe nevoja për role të reja te mësimdhënësit në AFP. • Rolet e mësimdhënësit në një mjedis të nxëni të orientuar nga veprimi dhe me nxënësin/kursantin në qendër: - mësimdhënësi si "organizator" i procesit mësimor; - mësimdhënësi si "pjesëmarrës" aktiv në procesin mësimor; - mësimdhënësi si "vlerësues" i arritjeve" të nxënësve/kursantëve; - mësimdhënësi si "mbështetës" i procesit të të nxënit; - mësimdhënësi si person "burimor" i procesit të të nxënit; - mësimdhënësi si "kujdestar" i nxënësve/kursantëve; - mësimdhënësi si "mbikqyrës" i procesit të të nxënit; - mësimdhënësi si "kontrollues" i procesit mësimor; - mësimdhënësi si "inovator digjital"; - mësimdhënësi si "këshillues i karrierës" për nxënësit/kursantët;

	- mësimdhënësi si "bashkëpunëtor" me bizneset/partnerët socialë në mbështetjen e procesit të të nxënit. • Rëndësia e aftësive digjitale në ushtrimin e roleve të reja të mësimdhënësit në AFP. • Rolet e mësimdhënësit të AFP në një mjedis mësimor të orientuar nga puna. • Roli i mentorit të biznesit në AFP të dyfishtë (dual). ***Udhëzime për realizimin:*** • Shpjegim gojori ilustruar me prezantime në *powerpoint*. • Shembuj (video) të ushtrimit të roleve të ndryshme të mësimdhënësve në AFP. • Punë në grupe për analizën e roleve të reja të mësimdhënësve si lehtësues të të nxënit aktiv. • Lojë me role për ushtrimin e roleve të reja të mësimdhënësve. • Detyra individuale për eksplorimin e roleve të mësimdhënësve në didaktikën moderne. • Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me rolet e mësimdhënësve në AFP. • Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. • Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. • Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

4. Moduli "Krijimi i atmosferës pozitive në procesin mësimor".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**KRIJIMI I ATMOSFERËS POZITIVE NË PROCESIN MËSIMOR**	**MK-27-196-25**
Qëllimi i modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit njihen me mënyrat dhe teknikat për krijimin e një mjedisi mësimor që nxit etikën dhe komunikimin efektiv, zhvillon kompetencat kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës të nxënësve/kursantëve, si dhe mundëson zbatimin e parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes, parandalimin e braktisjes shkollore në AFP.	
Kohëzgjatja e Modulit	12 orë (2 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 6 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë. Rekomandohet: 50% Teori; 40% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 70% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi nxit etikën, komunikimin efektiv dhe veprimtaritë socio-emocionale në mjedisin mësimor. **RN2:** Pjesëmarrësi zhvillon aftësitë kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës, të nxënësve dhe kursantëve. **RN3:** Pjesëmarrësi zbaton parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor. **RN4:** Pjesëmarrësi harton dhe zbaton planin individual për nxënësit dhe kursantët në rrezik braktisje.	
RN1	**Pjesëmarrësi nxit etikën, komunikimin efektiv dhe veprimtaritë socio-emocionale në mjedisin mësimor.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Rëndësia dhe kuptimi për etikën dhe komunikimin në mjedisin mësimor. • Të dëgjuarit dhe përcjellja e mesazhit gjatë komunikimit. • Llojet e komunikimit, komunikimi verbal dhe joverbal. • Barrierat e komunikimit në procesin mësimor. • Karakteristikat e komunikimit efektiv në mësim. • Roli i komunikimit në efektivitetin e procesit mësimor. • Komunikimi dhe motivimi i nxënësve/kursantëve. • Teknologjia dhe komunikimi. • Roli i veprimtarive socio-emocionale në përmirësimin e komunikimit në mjedisin mësimor. • Standardet bazë të mësimdhënësit në lidhje me komunikimin ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj dhe prezantime në *powerpoint*.	

	○ Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për komunikimin në mësim. ○ Punë në grupe/lojë me role për eksplorimin e etikës dhe komunikimit në mësim. ○ Detyra për mbledhje informacioni në lidhje me karakteristikat e komunikimit efektiv. ○ Veprimtari për integrimin e aktiviteteve socio-emocionale në mjedisin mësimor. ○ Vlerësimi i vazhduar gjatë trajnimit dhe vlerësim i detyrave të dhëna. ○ Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi zhvillon aftësitë kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës, të nxënësve dhe kursantëve.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore*:** • Kuptimi për aftësitë kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës. • Kompetencat kyçe si qasje transversale në veprimtaritë shkollore dhe në lëndët/modulet mësimore, si dhe impakti për zhvillimin personal, profesional dhe integrimin në tregun e punës të nxënësve/kursantëve. • "Aftësitë e shekullit 21", klasifikimi dhe tiparet e tyre: - aftësitë komunikuese; - aftësitë bashkëpunuese; - aftësitë kërkimore/krijuese; - aftësitë për të nxënë; - aftësitë negociuese; - aftësitë për zgjidhje problemesh; - aftësitë udhëheqëse/organizuese; - aftësitë financiare/sipërmarrëse; - aftësitë digjitale/teknologjike; - aftësitë e gjelbra; • Integrimi i aftësive kyçe në përmbajtjet mësimore në AFP. • Integrimi i aftësive kyçe në procesin mësimor në AFP. ***Udhëzime për realizimin:*** ○ Shpjegim gojor i ilustruar prezantime në *powerpoint*. ○ Shembuj të formulimit të aftësive kyçe ○ Punë në grupe për integrimin e aftësive kyçe të të nxënit përgjatë gjithë jetës dhe e aftësive të shekullit të 21 në përmbajtjet dhe në procesin mësimor, sipas drejtimeve profesionale. ○ Detyra individuale për eksplorimin e aftësive kyçe, të lidhura me drejtime profesionale të caktuara. ○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me integrimin e aftësive kyçe në përmbajtjet dhe procesin mësimor. ○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. ○ Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në format online–të sinkronizuar.

RN3	**Pjesëmarrësi zbaton parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore***: • Kuptimi për "barazinë" dhe "shancet e barabarta" në AFP. • Parimet e barazisë dhe shanceve të barabarta të zbatuara në AFP . • Kuptimi për "gjithëpërfshirjen" në AFP. • Parimet e gjithëpërfshirjes të zbatuara në AFP . • Rrugët për krijimin e shanceve të barabarta, fuqizimin e aksesit dhe gjithëpërfshirjes në AFP. • Kuptimi për "personat me nevoja të veçanta" dhe veçoritë e tyre. • Rrugët për mbështetjen e zhvillimit të nxënësve/kursantëve me nevoja të veçanta në AFP, bashkëpunimi me mësuesit ndihmës. • Kuptimi për "diversitetin" në AFP. • Parimet e respektimit të diversitetit (pavarësisht racës, kombësisë, gjinisë, besimit fetar, orientimit seksual, statusit social-ekonomik, moshës, orientimit politik etj.). • Rrugët për integrimin e parimeve të diversitetit në në AFP. • Rëndësia e integrimit të veprimtarive që nxisin barazinë, diversitetin, gjithëpërfshirjen në nivel shkolle/qendre, klase/grupi, lënde/moduli dhe biznesi. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të zbatimit të parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor në AFP. o Diskutime dhe përvoja të pjesëmarrësve në lidhje me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në AFP. o Punë në grupe për integrimin e parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor në AFP. o Detyra individuale për eksplorimin e parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në procesin mësimor në AFP. o Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me gjetjet. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN4	**Pjesëmarrësi zbaton planin individual për nxënësit dhe kursantët në rrezik braktisje.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore***: • Kuptimi për "braktisjen shkollore" në AFP. • Sistemi i paralajmërimit të hershëm për parandalimin e braktisjes shkollore. • Mjetet për identifikimin e nxënësve dhe kursantëve në rrezik braktisje. në AFP. • Vlerësimi i nevojave të nxënësve dhe kursantëve në rrezik braktisje.

	• Hartimi i planit individual me masat e ndërhyrjes dhe monitorimit, për shmangjen e braktisjes. • Zbatimi i planit individual me masat e ndërhyrjes dhe monitorimit, për shmangjen e braktisjes. • Referimi i nxënësve që braktisin shkollën në institucionet përkatëse. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të zbatimit të planit individual të nxënësve dhe kursantëve në rrezik braktisje. o Diskutime dhe përvoja të pjesmarrësve në lidhje me mjetet për identifikimin e nxënësve dhe kursantëve në rrezik braktisje. o Punë në grupe për hartimin e planit individual të nxënësve dhe kursantëve në rrezik braktisje. o Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me identifikimin, monitorimin, referimin e nxënësve/kursantëve në rrezik braktisje. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

5. Moduli "Menaxhimi i mjedisit, mjeteve dhe materialeve mësimore në AFP".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**MENAXHIMI I MJEDISIT, MJETEVE DHE MATERIALEVE MËSIMORE NË AFP**	**MK-27-021-25**
Qëllimi i Modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit aftësohen për të krijuar dhe mirëmbajtur mjedisin dhe mjetet mësimore efektive dhe të sigurta, për të përdorur medie të ndryshme didaktike dhe për të përgatitur materiale mësimore mbështetëse në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit mësimor në AFP.	
Kohëzgjatja e Modulit	18 orë (3 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 9 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë. Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 30% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi përgatit dhe mirëmban mjedisin dhe mjetet mësimore. **RN2:** Pjesëmarrësi përdor medie mësimore. **RN3**: Pjesëmarrësi përgatit materiale mësimore mbështetëse.	
RN1	**Pjesëmarrësi përgatit dhe mirëmban mjedisin dhe mjetet mësimore.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Rëndësia e parapërgatitjes së mjedisit dhe mjeteve mësimore të përshtatshme. • Klasifikimi i mjediseve mësimore në AFP. • Klasifikimi i mjeteve mësimore në AFP. • Simulimi i mjediseve reale të punës, në kushtet e shkollës/qendrës. • Kushtet, kriteret dhe standardet për mjedisin mësimor të përshtatshëm dhe të sigurtë (hapësirat, ndriçimi, ajrimi, temperatura, pajisjet etj.). • Siguria dhe higjiena e mjedisit dhe mjeteve mësimore. • Roli i mjedisit dhe mjeteve mësimore për zhvillimin e qëndrueshëm. • Mirëmbajtja e vazhdueshme e mjedisit mësimor. • Kujdesi në përdorimin dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e mjeteve mësimore. • Planifikimi i mjedisit dhe i mjeteve mësimore për mësimin teorik. • Planifikimi i mjedisit dhe i mjeteve mësimore për mësimin praktik. • Planifikimi i mjedisit dhe i mjeteve mësimore për mësimin online dhe të kombinuar (*blended*). • Krijimi i lidhjeve me biznesin rajonal dhe organizimi i praktikës së nxënësve dhe kursantëve në mjedise reale pune. • Mjedisi dhe mjetet mësimore në AFP të dyfishtë. ***Udhëzime për realizimin:***	

	○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint* si dhe demonstrime praktike. ○ Detyra në grupe për planifikimin e mjedisit dhe të mjeteve mësimore. ○ Prezantime të veprimtarive për mirëmbajtjen e mjedisit dhe të mjeteve mësimore. ○ Diskutime për aspekte të ndryshme të planifikimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit dhe mjeteve mësimore. Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës me gojë dhe me listë kontrolli. ○ Trajnimi zhvillohet në klasë dhe në mjedise për mësimin praktik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi përdor medie mësimore.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për mediet mësimore. • Rëndësia e përdorimit të medieve mësimore. • Klasifikimi i medieve mësimore. • Kushtet dhe kriteret për përdorimin e medieve mësimore. • Përdorimi i tabelave të shkrimit (e zezë, e bardhë, jeshile etj.). • Përdorimi i flipçartit. • Përdorimi i pinbordit. • Përdorimi i pankartave. • Përdorimi i kartave të murit. • Përdorimi i maketeve/modeleve. • Përdorimi i laptopit dhe projektorit elektronik. • Planifikimi i medieve për mësimin teorik. • Planifikimi i medieve për mësimin praktik. ***Udhëzime për realizimin:*** ○ Shpjegim gojor i ilustruar me demonstrime të përdorimit të medieve didaktike. ○ Shfaqje të vidiove që tregojnë përdorimin e medieve didaktike. ○ Praktikim individual për përdorimin e medieve didaktike. ○ Demonstrim nga pjesëmarrësit për përdorimin e medieve didaktike. ○ Diskutime për aspektet e përdorimit të medieve didaktike. ○ Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës me gojë dhe me listë kontrolli. ○ Trajnimi zhvillohet në klasë dhe në mjedise për mësimin praktik. ○ Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar**.**
RN3	**Pjesëmarrësi përgatit materiale mësimore mbështetëse.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për materialet mësimore mbështetëse. • Rëndësia e përdorimit të materialeve mësimore mbështetëse.

	• Llojet e materialeve mësimore mbështetëse. • Kushtet dhe kriteret për përgatitjen e materialeve mësimore. • Përgatitja e materialeve mësimore të shkruara për nxënësit e kursantët. • Përgatitja e prezantimeve. • Përgatitja e udhëzuesve të punës, detyrave, projekteve, eseve. • Përgatitja e portofolit të të nxënit. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj të materialeve mësimore. o Praktikim individual për përgatitjen e materialeve mësimore. o Prezantime nga pjesmarrësit për përgatitjen e materialeve mësimore. o Diskutime për aspekte të përgatitjes së materialeve mësimore. o Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës me gojë dhe me listë kontrolli. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

6. Moduli "Vlerësimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP".

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**VLERËSIMI I NXËNËSVE DHE KURSANTËVE NË AFP**	**MK-27-022-25**
Qëllimi i modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit njihen me parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP, si dhe zhvillojnë aftësi për hartimin e instrumenteve të ndryshme për vlerësimin dhe provimet e nxënësve dhe kursantëve.	
Kohëzgjatja e Modulit	30 orë (5 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 15 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë. Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 50% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1**: Pjesëmarrësi analizon kuptimin, rëndësinë, parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. **RN2**: Pjesëmarrësi përshkruan format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. **RN3**: Pjesëmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve. **RN4**: Pjesëmarrësi përgatit rubrika për vlerësimin dhe provimet e nxënësve dhe kursantëve.	
RN1	**Pjesëmarrësi analizon kuptimin, rëndësinë, parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për vlerësimin e nxënësve/kursantëve • Rëndësia e procesit të vlerësimit në orientimin dhe përmirësimin e të nxënit në AFP. • Parimet themelore të vlerësimit të nxënësve/kursantëve: - objektiviteti - besueshmëria. - vleftshmëria. - prakticiteti. • Llojet e vlerësimeve të nxënësve/kursantëve: - vlerësim paraprak - vlerësimi i vazhduar (gjatë procesit mësimor). - vlerësim përmbledhës dhe përfundimtar (provimet) - vlerësim diagnostikues. - vlerësimi i bazuar në kriteret (standardet) - vlerësimi i bazuar në normën (renditjen) - vlerësimi i njohurive. - vlerësimi i shprehive praktike. - vlerësimi i qëndrimeve. • Veçoritë e vlerësimit të nxënësve/kursantëve në AFP	

	• Dhënia e rezultateve të vlerësimit (skemat e notimit). ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të llojeve të ndryshme të vlerësimeve. o Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me parimet dhe llojet e vlerësimeve. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar
RN2	**Pjesëmarrësi përshkruan format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore*** • Format dhe metodat e vlerësimit të nxënësve/kursantëve. • Kuptimi për instrumentet e vlerësimit të nxënësve/kursantëve. • Klasifikimi i instrumenteve për vlerësimin e nxënësve/kursantëve. • Instrumentet për vlerësimin e njohurive: - pyetje-përgjigje me gojë (të hapura dhe të mbyllura) - pyetje-përgjigje me shkrim (të hapura dhe të mbyllura) - testet teorike dhe rregullat e përgatitjes së tyre • Instrumentet për vlerësimin e shprehive: - listat e kontrollit për vlerësimin e procesit të punës - listat e kontrollit për vlerësimin e produktit të punës • Instrumentet për vlerësimin e qëndrimeve (sjelljeve). • Instrumentet për vlerësimin e integruar – Portofoli, fletorja/dosja e nxënësit/kursantit praktikant (rubrikat e vlerësimit, detyrat, projektet). • Kriteret e përzgjedhjes së instrumenteve të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. • Provimet përmbledhëse/përfundimtare teorike dhe praktike, administrimi i tyre. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të instrumenteve të vlerësimit të llojeve të ndryshme. o Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me format, metodat dhe instrumentet e vlerësimeve. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për format, metodat dhe instrumentet e vlerësimeve. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

RN3	**Pjesëmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Hapat për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. • Faktorët që konsiderohen për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit. • Përgatitja e pyetjeve me përgjigje me gojë (të hapura dhe të mbyllura) për vlerësimin e njohurive. • Përgatitja e instrumenteve për vlerësimin e njohurive, me shkrim: • Përgatitja e njësive të testit/pyetjeve me përgjigje të hapura (ese-ve) • Përgatitja e njësive të testit/pyetjeve me përgjigje të mbyllura: - njësi testi/pyetje me plotësim të pjesës që mungon; - njësi testi/pyetje me PO ose JO; - njësi testi/pyetje me alternativa (me zgjedhje të shumëfishtë); - njësi testi/pyetje me kombinim. - njësi testi/pyetje me plotësim të elementëve që mungojnë në figura/diagrama • Përgatitja e testeve komplekse me shkrim. • Përgatitja e listave të kontrollit për vlerësimin e shprehive: - përgatitja e listave të kontrollit për vlerësimin e procesit të punës; - përgatitja e listave të kontrollit për vlerësimin e produktit të punës; • Përgatitja e listave të kontrollit që integrojnë vlerësimin e kompetencave ndërdisiplinore (aftësitë e buta, aftësitë e gjelbra, aftësitë digitale dhe të qëndrueshme). • Përgatitja e detyrave dhe projekteve praktike për vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. • Konceptimi i dosjeve për vlerësimin e nxënësve/kursantëve. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të instrumenteve të vlerësimit të njohurive, shprehive dhe qëndrimeve. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për instrumentet e vlerësimit. o Lojë me role për praktikimin e vlerësimit të njohurive, me gojë. o Detyra individuale për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit të njohurive, shprehive dhe qëndrimeve (me shkrim). o Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me instrumentet e vlerësimit. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave dhe lojës me role. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online, të sinkronizuar

RN4	**Pjesëmarrësi përgatit rubrika për vlerësimin dhe provimet e nxënësve dhe kursantëve.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për rubrikat e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve. • Faktorët kryesorë që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të rubrikave të vlerësimit. • Struktura e rubrikave të vlerësimit. • Përcaktimi i "peshave" të kritereve në vlerësimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve. • Llogaritja e rezultatit (notës) sipas rubrikës së vlerësimit. • Përgatitja e rubrikave për vlerësimin e njohurive. • Përgatitja e rubrikave për vlerësimin e shprehive. • Përgatitja e rubrikave për vlerësimin e qëndrimeve. • Hartimi i rubrikave të vlerësimit komplekse, që integrojnë njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet. • Përgatitja e rubrikave të vlerësimit për provimet përfundimtare teorike dhe praktike. ***Udhëzime për realizimin***: o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të përgatitjes së rubrikave të vlerësimit. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për rubrikat e vlerësimit. o Punë në grupe për përgatitjen e rubrikave të vlerësimit. o Detyra individuale për përgatitjen e rubrikave të vlerësimit. o Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me rubrikat e vlerësimit. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

7. Moduli "Mjedisi dhe mësimi digjital në AFP".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**MJEDISI DHE MËSIMI DIGJITAL NË AFP**	**MK-27-197-25**
Qëllimi i modulit	Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të përdorin në mënyrë të sigurt mjedisin dhe mjetet digjitale në procesin mësimor, të hartojnë materiale mësimore dhe instrumente vlerësimi digjitale, të kryejnë mësimin online dhe të kombinuar (*blended*), të realizojnë vlerësimin digjital, të angazhohen në rrjete profesionale online, të përdorin SMIP dhe dokumentacionin digjital shkollor, si dhe të zhvillojnë aftësitë digjitale të nxënësve dhe kursantëve.	
Kohëzgjatja e Modulit	30 orë (5 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 15 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë. Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime. Rreth 70% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi përdor mjedisin dhe mjetet digjitale për mësimin digjital. **RN2:** Pjesëmarrësi përgatit materiale didaktike digjitale. **RN3:** Pjesëmarrësi përgatit instrumente dhe kryen vlerësimin digjital të nxënësve dhe kursantëve. **RN4:** Pjesëmarrësi realizon mësimin online dhe të kombinuar (*blended*). **RN5:** Pjesëmarrësi angazhohet në rrjetet profesionale online. **RN6:** Pjesëmarrësi menaxhon dokumentacionin dhe informacionin digjital shkollor.	
RN1	**Pjesëmarrësi përdor mjedisin dhe mjetet digjitale për mësimin digjital.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi për "mësimin digjital", "mjedisin digjital" dhe "mjetet digjitale". • Kuptimi për platformat dhe programet digjitale. • Rëndësia e përdorimit të mësimit digjital në AFP. • Siguria në platformat/web për qëllime mësimore, si dhe siguria kibernetike në përgjithësi. • Përparësitë dhe mangësitë e mësimit digjital. • Kuptimi për "Sistemin e Menaxhimit të Mësimit - SMM" (*Learning Management System - LMS*). • Kriteret për përzgjedhjen e SMM (të tilla si *Google Classroom, MesoVET, Moodle* etj.). • Krijimi i "klasave digjitale" në një SMM të përzgjedhur. • Llojet e veprimtarive mësimore që planifikohen për nxënësit në platformat digjitale. • Ngarkimi i materialeve mësimore në mjedisin digjital të të nxënit.	

	• Përzgjedhja e mjeteve (*tools*) digjitale për mësimin online (të tilla si *Google Meet, Zoom, MS Teams* etj.). • Aspektet teknike të mësimit online (zëri, figura etj.). • Komandat e ndryshme për mësimin online (*mute, chat, sharing of material, break out rooms, polls* etj.). • Analiza e mundësive për zbatimin e mjedisit dhe mjeteve digjitale në ofruesit e AFP, të pjesëmarrësve. • Përdorimi i SMIP nga mësuesit në shkollat profesionale. • Informimi për rreziqet dhe sigurinë në përdorimin dhe shpërndarjen e informacionit personal të nxënësve/kursantëve dhe mësimdhënësve në platformat digjitale. • Zhvillimi i aftësive të nxënësve/kursantëve per të përdorur në mënyrë të sigurt mjetet dhe mjedisin digjital. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime dhe demonstrime në lidhje me krijimin e mjedisit mësimor digjital. o Shpjegim teorik i ilustruar me prezantime dhe demonstrime në lidhje me përdorimin e mjeteve digjitale në mësim. o Punë në grupe në lidhje me zbatimin e teknikave të mësimdhënies digjitale. o Lojë me role dhe simulim të mjedisit mësimor digjital, me përdorimin e mjeteve digjitale. o Detyra individuale për mbledhje informacioni në lidhje me mjedisin mësimor digjital dhe mjetet digjitale. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për zbatimin e mësimit online në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të pajisura me mjetet dhe programet e duhura për mësimin digjital. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi përgatit materiale didaktike digjitale.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Rëndësia e përdorimit të materialeve didaktike digjitale, në mësimin tradicional dhe në mësimin digjital (*e-learning*). • Llojet e materialeve didaktike digjitale dhe veçoritë e tyre. • Përdorimi i motorëve të kërkimit për burime të materialeve mësimore digjitale tipike për AFP (Interneti; burimet arsimore të hapura, rrjetet sociale etj.). • Teknikat e shkarkimit dhe editimit të materialeve mësimore digjitale nga Interneti. • Teknika të evidentimit dhe përdorimit të burimeve te sigurta të informacionit. • Analiza e përmbajtjes së kurrikulit dhe përcaktimi i nevojave për materiale didaktike digjitale.

	• Analiza e mjedisit mësimor digjital (platformave, programeve, mjetet për komunikim, mjetet interaktive etj.) dhe e mundësive për krijimin dhe përdorimin në procesin mësimor të materialeve didaktike digjitale. • Teknikat dhe rregullat e krijimit të dokumenteve digjitale • Teknikat dhe rregullat e krijimit të prezantimeve në *PowerPoint*. • Krijimi i prezantimeve multimediale digjitale. • Krijimi i tabelave dhe grafikëve në formate digjitale. • Teknikat e regjistrimit dhe editimit të materialeve digjitale në format audio (zanore). • Teknikat e regjistrimit dhe editimit të materialeve digjitale në format video (pamore). • Teknikat dhe rregullat e krijimit të materialeve didaktike digjitale nëpërmjet *screencast* (regjistrimit nga kompjuteri). • Krijimi i teksteve digjitale (*e-textbooks*) dhe librave të punës digjitale (*e-workbooks*). • Krijimi i testeve dhe *quizz*-eve digjitale. • Burimet tipike të materialeve didaktike digjitale tipike për AFP (Interneti; burimet arsimore të hapura, motorët kërkimorë, rrjetet sociale etj.). • Teknikat e "shkarkimit" dhe përpunimit të materialeve didaktike digjitale nga interneti. • Zhvillimi i aftësive të nxënësve dhe kursantëve për të përdorur motorët e kërkimit për materiale mësimore si dhe për të hartuar materiale në funksion të procesit mësimor. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime dhe shembuj në lidhje me llojet dhe formatet e materialeve didaktike digjitale. o Demonstrime të teknikave të përgatitjes dhe përdorimit të materialeve didaktike digjitale në procesin mësimor. o Punë në grupe në lidhje me përgatitjen e llojeve të ndryshme të materialeve didaktike digjitale. o Lojë me role dhe simulim të mjedisit mësimor digjital, me përdorimin e materialeve didaktike digjitale. o Detyra individuale për mbledhje informacioni dhe përgatitjen e materialeve didaktike digjitale, referuar lëndëve/moduleve që trajtojnë pjesëmarrësit. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve didaktike digjitale në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të pajisura me mjetet dhe programet e duhura për mësimin digjital dhe përgatitjen e materialeve didaktike digjitale. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.

RN3	**Pjesëmarrësi përgatit instrumente dhe kryen vlerësimin digjital të nxënësve dhe kursantëve.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Veçoritë e vlerësimit digjital të nxënësve dhe kursantëve në AFP. • Format dhe llojet e vlerësimit digjital. • Instrumentet digjitale për vlerësimin e nxënësve dhe kursantëve. • Përparësitë dhe kufizimet e vlerësimit digjital (bazuar te kompjuteri), krahasuar me vlerësimin tradicional (bazuar te letra dhe lapsi). • Testet e bazuara te kompjuteri (*computer-based tests*). • Llojet e testeve digjitale nisur nga qëllimi (vetëvlerësim, vlerësim i ndërmjetëm, vlerësim përmbledhës, provim përfundimtar) dhe veçoritë e tyre. • Llojet e testeve digjitale sipas formateve (të hapur, gjysëm të hapur, të mbyllur) dhe veçoritë e tyre. • Variacionet e testeve digjitale për qëllime të ndryshme, të përshtatura për platforma dhe programe të ndryshme. • Testet online (Internet) dhe testet në mjedis digjital të mbyllur (LAN), • Përdorimi i platformave *MS Teams, Moodle, OpenEdx* etj., për zhvillimin e testeve digjitale. • Formatet dhe teknikat e hartimit të testeve digjitale. • Përdorimi i funksioneve të ndryshme, në platforma të ndryshme, për hartimin e testeve digjitale. • Transformimi i testeve "letër-laps" në teste digjitale. • Llojet e ndryshme të njësive (pyetjeve) të testeve digjitale: - pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, me një përgjigje të saktë; - pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, me disa përgjigje të sakta; - pyetje me "*drag and drop*" (tërhiq dhe vendos); - pyetje me plotësim të pjesës që mungon në tekst/skemë; - pyetje me "PO" dhe "JO" (True/False); - pyetje me përgjigje të strukturuar (ese); - etj. • Formatimi, grupimi, renditja e njësive të testit në testet digjitale. • Caktimi i datës, kohës së fillimit dhe kohëzgjatjes së testit digjital. • Vënia e testeve të përgatitura në dispozicion të grupit të nxënësve ose kursantëve. • Monitorimi i pjesëmarrjes së nxënësve dhe kursantëve në testet e bazuara te kompjuteri. • Lexuesit optikë të testeve të formatit "letër me laps". • Zhvillimi i instrumenteve të "vlerësimit automatik": - caktimi i pikëve për çdo pyetje; - fidbek i menjëhershëm për çdo pyetje (e vërtetë ose e gabuar); - fidbek i shkurtër për përgjigjen e saktë; • Llogaritja automatike e rezultateve të vlerësimit, analiza statistikore. • Dhënia e *fidback*-ut në vlerësimin digjital. • Rreziku i kopjimit/plagjiaturës në testet online dhe garantimi i besueshmërisë së vlerësimit.

	• Masat për garantimin e sigurisë dhe të fshehtësisë (sekretimit) të testeve digjitale. • Vendosja e kritereve të hyrjes në test (provim): - nga një vend i caktuar (p.sh., hapësira e internetit të shkollës/qendrës) - nëpërmjet një kodi të veçantë që merret në një link të caktuar etj. • Mirëmbajtja dhe përditësimi i sistemeve të vlerësimit digjital. • Masat e sigurisë për integritetin e testimit online. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime dhe shembuj në lidhje me llojet dhe formatet e instrumenteve të vlerësimit digjital. o Demonstrime të teknikave të përgatitjes dhe përdorimit të instrumenteve të vlerësimit digjital. o Punë në grupe në lidhje me përgatitjen e llojeve dhe formateve të ndryshme të instrumenteve të vlerësimit (testeve) digjital. o Lojë me role dhe simulim të mjedisit mësimor digjital, me përdorimin e instrumenteve të vlerësimit digjital. o Detyra individuale për mbledhje informacioni dhe përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit digjital, referuar lëndëve/moduleve që trajtojnë pjesëmarrësit. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për përgatitjen dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit digjital në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. o Zhvillimi i trajnimit në mjedise të pajisura me teknologjitë e nevojshme. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.
RN4	**Pjesëmarrësi realizon mësimin online dhe të kombinuar (*blended*).** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Nevoja për mësimin online dhe për mësimin e kombinuar (*blended*) në AFP. • Formatet kryesore të mësimit digjital (*e-learning*) që zbatohen në AFP. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online sinkron. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online asinkron. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online linear. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online individual (të personalizuar). • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online bashkëpunues. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit online interaktiv. • Veçoritë dhe përdorimet e mësimit të kombinuar (*blended*). • Veçoritë dhe përdorimet e programeve të simulimit (virtuale). • Veçoritë dhe përdorimet e programeve të lojrave mësimore. • Përparësitë dhe kufizimet e zbatimit të formateve të ndryshme të mësimit online dhe të kombinuar në AFP.

	• Mjetet, pajisjet dhe programet e nevojshme për zbatimin e formateve të ndryshme të mësimit online dhe të kombinuar. • Zhvillimi te nxënësit dhe kursantët i aftësive për të marrë pjesë në mësimin online dhe të kombinuar. ***Udhëzime për realizimin***: o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime dhe shembuj në lidhje me llojet, formatet dhe veçoritë e mësimit online dhe të kombinuar. o Demonstrime të zbatimit të formateve të ndryshme të mësimit online dhe të kombinuar. o Punë në grupe në lidhje me planifikimin dhe praktikimin e formateve të ndryshme të mësimit online dhe të kombinuar. o Lojë me role dhe simulim të mjedisit mësimor digjital, për zbatimin e mësimit online dhe të kombinuar. o Detyra individuale për mbledhje informacioni dhe përgatitjen e mësimit online dhe të kombinuar, referuar lëndëve dhe moduleve që trajtojnë pjesëmarrësit. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për planifikimin dhe zbatimin e mësimit online dhe të kombinuar në AFP. o Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të pajisura me mjetet dhe programet e duhura për mësimin mësimin online dhe të kombinuar. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.
RN5	**Pjesëmarrësi angazhohet në rrjetet profesionale online.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Kuptimi i rrjeteve profesionale dhe i rrjeteve profesionale online. • Qëllimi dhe funksioni i rrjeteve profesionale online, në mësimdhënie. • Rëndësia e rrjeteve profesionale për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe shkëmbimin e përvojës së tyre. • Siguria dhe etika në rrjetet profesionale online - mbrojtja e të dhënave personale dhe profesionale. - menaxhimi i diskutimeve dhe komunikimit etik online. - shmangia e dezinformimeve dhe burimeve jo të verifikuara. • Mënyra e funksionimit të rrjeteve profesionale online: - modelet e komunikimit (sinkron/asinkron). - rregullat e bashkëpunimit dhe etika profesionale online. - praktikat e moderimit dhe organizimit në komunitetet online. - llojet e kontributeve: postime, komente, ndarje materialesh, webinare, diskutime etj. • Udhëzime për pjesëmarrje aktive në rrjetet profesionale online. • Shembuj praktikë të rrjeteve profesionale online (Facebook Groups, WhatsApp, LinkedIn, Moodle, Google Classroom etj.). • Praktikimi i antarësimit aktiv dhe i veprimtarive në rrjetet profesionale

	online për mësimdhënësit në AFP. • Zhvillimi te nxënësit dhe kursantët i aftësive për zhvillim të vazhdueshëm profesional bazuar në burimet online. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime dhe shembuj në lidhje me përdorimin e mediave socialet dhe rrjeteve profesionale online për zhvillimin e vazhduar profesional dhe shkëmbimin e përvojës së mësimdhënësve. o Demonstrime të antarësimit dhe të përdorimit të rrjeteve profesionale online për qëllime mësimore. o Punë në grupe në lidhje me anëtarësimin dhe praktikimin e pjesmarrjes aktive në rrjete profesionale online. Lojë me role dhe simulime në lidhje me anëtarësimin dhe praktikimin e pjesmarrjes aktive në rrjete profesionale online. o Detyra individuale për mbledhje informacioni dhe pjesëmarrje aktive në rrjete profesionale online. o Prezantime të detyrave dhe diskutime për anëtarësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive në rrjete profesionale online. o Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. o Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të pajisura me mjetet dhe programet e duhura për pjesëmarrje aktive në komunitetet e praktikës së mësimdhënësve në AFP. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.
RN6	**Pjesëmarrësi menaxhon dokumentacionin dhe informacionin digjital shkollor.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Sistemet dhe platformat digjitale të përdorura nga ofruesit e AFP për menaxhimin e dokumentacionit dhe informacionit shkollor (p.sh. SMIP, platforma MesoVET, etj). • Funksionet dhe përparësitë që ofrojnë sistemet digjitale të menaxhimit të dokumentacionit (akses i shpejtë, automatizimi, komunikimi, transparenca, siguria e të dhënave). • Llojet e dokumentacionit shkollor në format digjital: - dokumentet administrative; - dokumentet për burimet njerëzore; - dokumentet planifikuese; - dokumentet kurrikulare/mësimore; - dokumentet për nxënësit/kursantët; - formate dhe raporte vlerësimi - dokumente të tjera; • Teknikat dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet sistemeve digjitale (komunikimi zyrtar, njoftimet, transferimi i të dhënave).

	• Procedurat e aksesit, plotësimit dhe përditësimit të dokumentacionit digjital nga mësimdhënësit e AFP, bazuar në rolet dhe të drejtat e përdoruesve. • Koncepti i "Arkivës digjitale", rëndësia e saj. • Arkivimi (ruajtja afatgjatë, strukturimi dhe kategorizimi i dokumenteve) dhe siguria e dokumentacionit digjital shkollor. • Zhvillimi i aftësive të nxënësve dhe kursantëve për përdorimin e dokumentacionit digjital shkollor. ***Udhëzime për realizimin:*** • Shpjegim teorik i ilustruar me prezantime dhe shembuj në lidhje me llojet, formatet dhe veçoritë e dokumentacionit shkollor digjital. • Demonstrime të shkëmbimit të informacionit dhe plotësimit të dokumentacionit shkollor digjital, nëpërmjet sistemeve dhe programeve përkatëse. • Punë në grupe në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor digjital. • Lojë me role dhe simulim të veprimtarive për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor digjital. • Detyra individuale për mbledhje informacioni, shkëmbim të informacionit dhe plotësim të dokumentacionit shkollor digjital, referuar shkollave, lëndëve dhe moduleve përkatëse. • Prezantime të detyrave dhe diskutime për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor digjital. • Vlerësimi i vazhduar gjatë vëzhgimit të praktikimit dhe demonstrimit të pjesëmarrësve, si dhe nëpërmjet përmbushjes së detyrave. • Trajnimi zhvillohet kryesisht në mjedise të pajisura me mjetet dhe programet (sistemet) e duhura për shkëmbimin e informacionit dhe plotësimin e dokumentacionit shkollor digjital. • Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin e kombinuar (*blended*) ose online – të sinkronizuar.

8. Moduli "Planifikimi dhe realizimi i mësimit në AFP".

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modulit	**PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I MËSIMIT NË AFP**	**MK-27-023-25**
Qëllimi i Modulit	Nëpërmjet këtij moduli pjesmarrësit njihen me veçoritë dhe kërkesat e procesit mësimor në AFP, aftësohen që të përgatisin plane të mësimdhënies, si dhe të planifikojnë e realizojnë seanca mësimore teorike, praktike, online dhe të kombinuara (*blended*).	
Kohëzgjatja e Modulit	42 orë (7 ditë) trajnim i drejtpërdrejtë dhe 21 orë trajnim jo i drejtpërdrejtë. Rekomandohet: 10% Teori; 70% Praktikë; 20% Vlerësime. Rreth 30% kohës së modulit mund të realizohet në format online.	
Rezultatet e të Nxënit (RN)	**RN1:** Pjesëmarrësi përgatit plane të mësimdhënies për lëndët dhe modulet mësimore. **RN2:** Pjesëmarrësi përshkruan veçoritë dhe fazat e mësimit teorik dhe të mësimit praktik në AFP. **RN3:** Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron seanca mësimore teorike. **RN4:** Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron seanca mësimore praktike.	
RN1	**Pjesëmarrësi përgatit plane të mësimdhënies për lëndët dhe modulet mësimore.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** o Rëndësia e planifikimit të procesit mësimor në AFP. o Fazat e planifikimit të mësimit. o Faktorët që konsiderohen gjatë planifikimit të mësimit teorik dhe praktik. o Struktura (rubrikat) e planit të mësimdhënies për lëndët teorike profesionale. o Procedura e zhvillimit të mëtejshëm të "programit të përgjithshëm të lëndës" në "planin e mësimdhënies" përkatës. o Struktura (rubrikat) e planit të mësimdhënies për modulet praktike profesionale. o Procedura e zhvillimit të mëtejshëm të "përshkruesit të modulit" në "planin e mësimdhënies" përkatës. o Veçoritë e planifikimit të praktikës profesionale në mjedise reale pune të bizneseve. o Veçoritë e zbatimit të planeve të mësimdhënies në procesin mësimor. ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të formateve të planeve të mësimdhënies së lëndëve teorike dhe moduleve praktike. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për plotësimin	

	e planeve të mësimdhënies. o Punë në grupe dhe detyra individuale për përgatitjen e planeve të mësimdhënies. o Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me plotësimin e rubrikave të planeve të mësimdhënies. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.
RN2	**Pjesëmarrësi përshkruan veçoritë dhe fazat e mësimit teorik dhe të mësimit praktik në AFP.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Veçoritë e planifikimit të seancave mësimore tipike për AFP. • Analiza e objektivave dhe përmbajtjeve mësimore. • Analiza e numrit të nxënësve/kursantëve në klasë/grup. • Analiza e kohës në dispozicion të seancave mësimore. • Analiza e kushteve mësimore: mjediseve, mjeteve, pajisjeve dhe materialeve në dispozicion. • Fazat e seancave mësimore me fokus teorinë profesionale. • Fazat e seancave mësimore me fokus praktikën profesionale: - shpjegimi nga mësimdhënësi i praktikës; - demonstrimi nga mësimdhënësi i praktikë; - praktika e mbikqyrur e nxënësve/kursantëve; - praktika e pavarur e nxënësve/kursantëve; - fidbeku dhe vlerësimi i nxënësve/kursantëve; • Planifikimi (ditari) i seancave mësimore të veçanta, teorike dhe/ose praktike. • Veçoritë e procesit mësimor në mjedis mësimor digjital dhe të kombinuar. • Veçoritë e procesit mësimor në mjediset reale të punës (në biznes). ***Udhëzime për realizimin:*** o Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*. o Shembuj të planifikimit të seancave mësimore teorike dhe praktike. o Diskutime në lidhje me përvojat e pjesëmarrësve për planifikimin e seancave mësimore. o Punë në grupe dhe detyra individuale për planifikimin e seancave mësimore teorike dhe praktike (ditareve). o Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me planifikimin e seancave mësimore. o Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave të dhëna. o Trajnimi zhvillohet në mjedise të mësimit teorik dhe praktik. o Seanca të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar.

RN3	**Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron seanca mësimore teorike.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore*:** • Përzgjedhja e një njësie mësimore teorike nga pjesëmarrësi. • Analiza e objektivave dhe përmbajtjeve mësimore të njësisë mësimore teorike. • Përzgjedhja e formatit/mjedisit mësimor (në klasë, *online*, *blended* etj.). • Planifikimi i veprimtarive mësimore (metodave) për njohuritë dhe lidhja me kompetencën profesionale përkatëse. • Përgatitja e "ditarit" për seancën mësimore teorike. • Përgatitja e materialeve mbështetëse për seancën mësimore teorike. • Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit me shkrim. • Përgatitja e mjedisit fizik dhe medieve didaktike për realizimin e seancës mësimore teorike. • Përgatitja e mjedisit virtual për seancën mësimore online dhe/ose të kombinuar. • Realizimi i hyrjes së mësimit. • Realizimi i shpjegimit të njohurive teorike. • Realizimi i diskutimit, punëve në grup, punëve të pavarura etj. • Dhënia e detyrave të klasës, të shtëpisë dhe online. • Kryerja e vlerësimit të shkallës së përvetësimit të njohurive. • Përmbyllja e seancës mësimore teorike. ***Udhëzime për realizimin:*** o Dhënia e detyrës për çdo pjesëmarrës. o Krijimi i kushteve të përshtatshme që çdo pjesëmarrës që të realizojë -seanca mësimore teorike, me prezencë fizike dhe/ose online. o Lojë me role për të simuluar realizimin e fazave të mësimit teorik. o Realizimi nga çdo pjesëmarrës i seancave mësimore teorike të simuluara. o Diskutime në lidhje me mësimet teorike të realizuara nga pjesëmarrësit. o Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës i çdo pjesëmarrësi i bazuar në dokumentacionin e përgatitur dhe në performancën e realizimit të seancës mësimore teorike. o Seancat mësimore teorike zhvillohen në klasa mësimore të pajisura me mjetet e duhura për mësimin teorik të simuluar, me prezencë fizike dhe/ose online. o Seanca mësimore teorike të veçanta mund të zhvillohen në formatin online – të sinkronizuar dhe të kombinuar - *blended*.

RN4	**Pjesëmarrësi planifikon dhe demonstron seanca mësimore praktike.** ***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:*** • Përzgjedhja nga pjesëmarrësi i një njësie mësimore për zhvillimin e një shprehie praktike. • Analiza e objektivave dhe përmbajtjeve mësimore të njësisë mësimore praktike. • Përzgjedhja e formatit/mjedisit mësimor (në klasë, në laborator, në repart, në mjedis pune të simuluar - *online dhe blended* etj.). • Planifikimi i veprimtarive mësimore (metodave) praktike dhe lidhja e shprehisë me kompetencën përkatëse të punës. • Përgatitja e "ditarit" për seancën mësimore praktike. • Përgatitja e udhëzuesit të punës dhe e listës së kontrollit. • Përgatitja e medieve dhe materialeve mësimore ilustruese mbështetëse. • Përgatitja e mjedisit të punës, mjeteve dhe materialeve shpenzuese. • Realizimi i hyrjes së seancës mësimore praktike. • Shpërndarja e materialeve mbështetëse dhe udhëzuese. • Shpjegimi nga pjesëmarrësi (mësimdhënësi) i shprehisë që do të fitohet nga nxënësit/kursantët. • Realizimi nga pjesëmarrësi (mësimdhënësi) i demonstrimit të shprehisë së punës. • Simulimi i praktikës së mbikëqyrur, nga nxënësit/kursantët. • Simulimi i praktikës së pavarur, nga nxënësit/kursantët. • Realizimi i vlerësimit të shkallës së përvetësimit të shprehisë praktike (procesit dhe/ose produktit të punës). • Dhënie detyrash praktike. • Përmbyllja e seancës së mësimit praktik. ***Udhëzime për realizimin:*** o Dhënia e detyrës praktike për çdo pjesëmarrës. o Krijimi i kushteve të përshtatshme që çdo pjesëmarrës që të realizojë seanca mësimore praktike. o Lojë me role për të simuluar realizimin e fazave të mësimit praktik. o Realizimi nga çdo pjesëmarrës i seancave mësimore praktike të simuluara. o Diskutime për mësimet praktike të realizuara nga pjesëmarrësit. o Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës i çdo pjesëmarrësi i bazuar në dokumentacionin e përgatitur dhe në performancën e realizimit të mësimit praktik. o Seancat mësimore praktike zhvillohen në mjedise mësimore të pajisura me mjetet dhe materialet e duhura për mësimin praktik përkatës (përfshirë dhe mjedise të simuluara *online* dhe *blended*). o Vëmendje i kushtohet zbatimit të masave të sigurisë dhe mjedisore.